



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 10.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkeses për ri-shqyrtim** të datës 10.01.2025 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **VED Group SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Ndërtimi i QKMF në Shtime”**, me nr. prokurimi **206-24-185-5-1-1**, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. **Refuzohet**, si e jashtafatshme kërkesa për rishqyrtim e OE **VED Group SH.P.K.** e datës 10.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Ndërtimi i QKMF në Shtime”**, me nr. prokurimi **206-24-185-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontrate të datës 19.12.2024 të publikuar në platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi për Kontratë, i datës 19.12.2024.
- III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor dhe AK-MSh vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**Arsyetim**

Operatoret Ekonomik **VED Group SH.P.K.** me datën 10.01.2025 kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i QKMF në Shtime”**, me nr. prokurimi **206-24-185-5-1-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 10.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues në lidhje me Kërkesen për Rishqyrtim të OE ankues:**

**Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim**

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Gjydhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

**“3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:**

Operatori Ekonomik ankues ka dorëzuar Kerkese per rishqyrtim me daten 10.01.2025, ndersa hapja e ofertave fillimisht eshte parapare me daten 13.01.2025.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankese pas afatit te fundit te lejuar 5 dite para dorezimit te ofertave.

#### **Nenin 60.1(a) i Rregullave te prokurimit pubik**

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

#### **Nenin 63.2 i Rregullave te prokurimit pubik**

Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkeses per rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

AK-MSh e hedh poshte ankesen e parashtrua ne perputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen percakton se:

**Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



**Berat Marmullaku**

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**